



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE  
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Lezhë, me date \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Sherbimi i mbikqyerjes se punimeve me objekt “Rikonstruksioni i Rrjetit te te fshatit Dajç, Njesia Administrative Dajç, Bashkia Lezhe”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79714000-2**  
**Sherbime per mbikqyrje**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,973,736.00 (nje milion e nenteqind e shtatedhete e tre mije e shtateqind e tridhete e gjashte) Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lezhë Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**Ofertuesi duhet të paraqesë:**

1. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*
2. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Adresa :Lagjja "Nene Tereza", Rruga Bajram Curri, Ndertese 2-Kateshe ne zonen kadastrale nr.8632, numri i pasurise 1/130, Lezhë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LIGJIT NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” I NDRYSHUAR, nenit 26, 30, të VKM.nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **3. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

Sipas Shtojcës Nr. 10

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

- Sipas Shtojcës Nr. 10

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LIGJIT NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” I NDRYSHUAR, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LIGJIT NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” I NDRYSHUAR, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 76, pika 2, e LIGJIT NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” I NDRYSHUAR, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatorët Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës së fondit limit që prokurohet, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si me poshte:

a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e suksesshëm të kesaj kontrate dhe faturat tatimore të shitjes origjinale, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore në librat e shitjes në muajin respektiv kur janë leshuar;

### OSE

b. Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e mbikqyrjes dhe faturat tatimore përkatëse, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore në librat e shitjes në muajin respektiv kur janë leshuar, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar VKM Nr.498 date 1.8.2024, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën*

ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

**2.3.2** Liçenca profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikqyrje dhe Kolaudim punimesh zbatimi ku të përfshihen kategorite:

- **NP- 1** Punime gërmimi në tokë
- **NP- 4** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai....
- **NP- 7** Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje
- **NS- 9** Punime strukturore speciale
- **NP 11** Ndertime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **NS-18** Punime topogjeodezike
- **NS-20** Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi. (Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” Meqenese kemi te bejme me mbikqyrjen e punimeve ne zbatim argumentojme se kategorite e mesiperme jane percaktuar ne perputhje me zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventivin e punimeve të zbatimit.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën 5 (pese) punonjës për periudhe Gusht 2024-Tetor 2024. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur sipas shërbimit konkret që kërkohet dhe punonjësve specialist që nevojiten dhe që janë kërkuar për këtë shërbim. Gjykohet se **5 (pesë) punonjës** janë të mjaftueshëm për realizimin me sukses të shërbimit, objekt kontrate.

**2.3.4** Operatorët ekonomikë, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknikë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet / Topograf 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog 1 (një)

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhen Gusht 2024-Tetor 2024. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë

kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

**2.3.5** Operatorët Ekonomikë ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2018**, “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

**Argumentimi:** Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Çertifikatat e cilësive janë bazuar në përputhje me objektin e zbatimit që do të mbikqyret dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

**Çertifikatë ISO 9001 - 2015** “Per Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte të cilësisë si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësitë, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve etj.

**Çertifikatë ISO 14001-2015** “Per sistemin e menaxhimit të mjedisit” kërket pasi angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi, kurse metoda me efikasë për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi menaxhimi për mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombëtar ISO 14001.

**Çertifikatë ISO 45001-2018** “Per sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve etj.

**2.3.6** OE duhet te kete ne pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi instrumentat topografik si me poshtë:

- 1 (nje) paisje GPS;
- 1 (nje) paisje Total Station.

Per kete duhet te paraqesë fature tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku i bashkengjitet fatura tatimore.

**Argumentimi :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.7** OE duhet të ketë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje automjet.

Per kete duhet te paraqesë:

- Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik;
  - siguracionin;
  - taksat vjetore.
- Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

**2.3.8** Operatoret ekonomik, duhet te paraqesi cv te shoqerise dhe stafit te propozuar, ku te perfshihen deshmi per kontrata te ngjashme, certifikata iso (ekuivalente), metodologji, perqasje teknike, plan pune, grafik sherbimi, organizim stafi, kualifikime, trajnime, vertetime per eksperience te meparshme ne mbikqyrje punimesh ujesjellesa, per qellime te vleresimit te propozimit teknik.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 2/b dhe 5 të nenit të 87, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 45, pika 4/ b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, keto dokumenta nevojiten per te bere nje vleresim teknik te ofertes se propozuar

2.3.9 Operatoret ekonomik duhet te plotesojne oferten (sipas Shtojces 1 dhe 2), duke ju referuar njoftimit të bërë me shkresen Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i azhornuar.

**Argumentimi:** Kriteri bazohet ne rekomandimin e Agjensia e Prokurimit Publik me shkresë Nr.5585 Prot. datë 25.07.2017 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne VKM nr.354 date 11.05.2016” dhe shkrases Nr. 13565 Pro.t date 06.11.2017 ”Terheqim Vemendjen”. Me qellim garantimin e realizimit te sherbimit ne kohe dhe me cilesi eshte gjykuar se respektimi i legjislacionit ne fuqi eshte i domosdoshem.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

***Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***



### **III. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Referuar shërbimit që kërkohet të kryhet, atij të mbikqyrjes së punimeve, në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar), dhe nenit 15 pika 3 gërma “c”, e nenit 41 pika 1 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ligjit Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 610, datë 22.09.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”, dhe Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit kreu hartimin dhe miratimin e specifikimeve teknike/ termave të refencës për shërbimin e mbikqyrjes.

- Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar nga specialist te fushes ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimenë planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates.